

STRATEGJIA
E ZHVILLIMIT TË
UNIVERSITETIT
"EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

PËR PERIUDHËN
2008 - 2013

PËRMBAJTA

- **HYRJA**
- **VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM DHE KUSHTET AKTUALE NË UNIVERSITETIN E GJIROKASTRËS**
- **MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE**
- **RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE EKZISTUESE TË STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TË REJA**
- **PËRMIREËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË UNIVERSITETIT “E. ÇABEJ”**
- **REKRUTIMI I STAFIT TË RI AKADEMIK**
- **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT**
- **KËRKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE**
- **LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBËTARE**
- **ROLI NDËRKOMBËTAR**
- **FINANCAT DHE BURIMET FINANCIARE**
- **KËRKESAT FINANCIARE TË STRATEGJISË**
- **QEVERISJA BASHKËKOHORE**
- **MBI SITUACIONIN NË UGJ**

HYRJE

Në vendin tonë ka gati dy dekada që ka filluar procesi i transformimit të arsimit sipas modeleve të sotme më të përparuara. Zhvillimi dhe institucionalizimi i politikave arsimore, modelet bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies garantojnë edhe suksesin e këtij procesi. Jemi zbatues e po zbatohen programe mjaft ambicioze që synojnë transformimin rrenjesor (ne strukture e permbajtje) te sistemit arsimor parauniversitar. Këtij zhvillimi i pergjigjet madje dhe i paraprine ristrukturimi dhe modernizimi i sistemit te Arsimit te Larte.

Ne Universitetin “Eqrem Çabej” mirepritin idete e reja bashkekohore, programet e perparuara per zhvillimin e shoqerise, ambicjet profesionale dhe angazhimet e mirefillta pedagogjike e shkencore. Ne Universitetin tone takohen dhe mirepritin kultura dhe rryma te ndryshme, gjithmone duke respektuar individualitetet historike, te sotmen dhe te ardhmen e gjithesecilit.

Perfshirja ne procesin e Bolonjes ka bere qe Universiteti i Gjirokastrës te angazhohet seriozisht per ndryshime ne strukture dhe permbajtje. Autonomia gjithmone e me e gjere po jep frytet e saj. Eshte rritur numri i studenteve, stafi akademik po behet gjithnje e me i kualifikuar, eshte rritur ndjeshem bashkepunimi i universitetit me universitetet si motra brenda e jashte vendit. Megjithate ndonjehere ne politikat arsimore te Arsimit te Larte nuk jane marre ne konsiderate ndryshimet e faktoreve te mjedisit si kerkesat e tregut, influencat e politikave rajonale, kufizimet ligjore, etj..

Transformimi i shoqerise po shoqerohet me ndryshime te shpejta dhe me nje shperthim te vrullshem te informacionit. Problemet e sotme nuk mund te zgjidhen me mendesite e meparshme. Shoqeria ka nevojë per qytetare qe te mendojne ndryshe nga vite me pare, te jene krijues, te mendojne ne menyre kritike, te jene ne gjendje te zgjidhin probleme sado te nderlikuara te jene ato dhe se fundi te jene te pajisur me shprehi per te menazhuar ndryshimet.

Hartimi, menaxhimi dhe zbatimi i nje Plani-Strategjik Zhvillimi te Universitetit do te jete kyçi i zhvillimit te suksesshem te universitetit tone dhe do te ndihmoje per nje integrim me te mire te universitetit me shoqerine dhe rajonin. Kjo eshte nje detyre qe rrjedh nga Ligji i Arsimit te Larte (neni 14, pika 2/b). Programi afatgjat/mesem per zhvilimin e Universitetit “E.Çabej” eshte ne pajtueshmëri me prirjet kryesore te zhvilimit te arsimit te larte ne Evrope dhe ne bote, dhe ne veçanti me procesin e Bolonjes. Ky

program afatgjat/mesem per zhvillimin e universitetit tone eshte zbatim konkret i Strategjise Kombetare per Arsimin e Larte (2008 – 2013) per politikat afatmesme dhe afatgjata ne veprimtarine e institucioneve te arsimit te larte, duke marre parasysh edhe sugjerimet e stafit akademik dhe grupeve studentore te interesuara per zhvillimin e ketij universiteti.

VESHTRIM I PERGJITHSHEM DHE KUSHTET AKTUALE NE UNIVERSITETIN E GJIROKASTRES

Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës është krijuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 414, datë 12.11.1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik që ishte çelur qysh me 1971. Ai është institucioni me i rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor i Rajonit Jugor të Shqipërisë. Arsimi i lartë në Gjirokastrë, deri sa u kalua në themelimin e Universitetit ka patur një traditë dhe përvijë të konsiderueshme. Me 1968 hapet Filiali i Fakultetit Ekonomik (pa shkeputje nga puna) të Universitetit të Tiranës, i cili vazhdoi për 11 vjet. Një vit më vonë (1969) hapet dhe dega e Agronomisë, si Filial i Institutit të Lartë Bujqësor, e cila zgjati 10 vjet. Po në këtë vit u hap gjithashtu Instituti Pedagogjik 2-vjeçar pa shkeputje nga puna për përgatitjen e mësuesve për specialitete të tilla si: Gjuhë-Letërsi, Histori – Gjeografi, Biologji-Kimi dhe Matematikë-Fizikë. Gjithashtu u hap dhe funksionoi për 5 vjet, Filiali i Institutit të Kulturës Fizike “Vojo Kushi”.

Mbi bazën e kësaj përvijë në vitin 1971, me Vendim të Keshillit të Ministrave, fillon veprimtarinë e tij Instituti i Lartë Pedagogjik 3-vjeçar me shkeputje nga puna, në fillim me degët Histori – Gjeografi dhe Matematikë – Fizikë. Në vitin 1980 hapet edhe dega e Biologji – Kimisë.

Në vitin 1981 Instituti i Lartë 3-vjeçar me Vendim të Keshillit të Ministrave, shndërrohet në Institut të Lartë Pedagogjik 4-vjeçar. Në këtë vit çëlet edhe dega e përgatitjes së mësuesve për shkollën fillore (Cikli i Ulet) dhe me Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 255, datë 24.07.1986 u hap edhe dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Për një periudhë prej 10 vjetësh Instituti i Lartë Pedagogjik 4-vjeçar u kompletua me të gjitha profilet e përgatitjes së mësuesve, u konsolidua e u pasurua me bazën e nevojshme materiale-mesimore. U ndertua korpusi i ri me të gjitha mjediset e nevojshme për mesim si dhe godina e konviktit. Nga viti në vit u rrit shkalla e kualifikimit shkencor e pedagogjik të personelit akademik.

Në vitin akademik 1993-1994, me Vendim të Keshillit të Ministrave perkatesisht nr.435, datë 03.09.1993 dhe nr. 300, datë 21.06.1994

Universiteti i Gjirokastrës u zgjerua edhe me hapjen e dy degëve të reja, perkatesisht të degës së Gjuhës e Letërsisë Greke, e cila përgatit mësues për shkollat e minoritetit grek dhe asaj të Gjuhës e Letërsisë Angleze. Në vitin akademik 1996-1997 hapet dega Kontabilitet – Finance si dhe dega e Arsimit Parashkollor. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.179, datë 29.09.1998 kursi i studimit të degës Cikli i Ulet u bë nga 3-vjeçar në 4-vjeçar.

Në vitin 1998 hapet kursi i degës Infermieri e Lartë dhe në qershor të vitit 2001 u çel edhe dega e Administrimit Publik. Në vitin 2003 hapet dega Gjuhë – Letërsi Italiane, në vitin 2004 hapet dega Matematikë – Informatikë dhe në vitin 2005 hapet dega e Turizmit.

Në përgjithësi kontingjenti i studentëve është nga rrethet e Shqipërisë së Jugut. Gjithashtu ka edhe mjaft studentë nga rajone të tjera jashtë kufijve të Shqipërisë si Kosova, Maqedonia dhe Greqia.

Pranimi i studentëve aktualisht bëhet mbi bazën e Matures Shtetërore. Studentët mund të ndjekin studimet me kohë të plote ose me kohë të pjesshme. Në vitin 1994 e në vazhdim, Universiteti “Eqrem Çabej” filloi funksionimin e tij mbi bazën e departamenteve (u suprimuan katedrat). Sipas Vendimit të Ministrisë së Arsimit nr.128, datë 27.10.1994 filluan të funksionojnë tre Fakultete dhe 10 Departamente. Sot UGJ ka 2 Fakultete dhe 14 programe studimi të ciklit të parë dhe 6 programe “Master” të nivelit të parë CLAB si më poshtë:

▪ **Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me këto programe studimi të ciklit të parë:**

- Gjuhë e Letërsi Shqipe,
- Histori-Gjeografi,
- Gjuhë e Letërsi Angleze,
- Gjuhë Letërsi Italiane,
- Gjuhë, Letërsi dhe Qyteterim Grek,
- Kontabilitet-Finance, Administrim Publik,
- Turizem,
- Mësuesi për Arsimin Fillor
- Mësuesi për Arsimin Parashkollor.

Në përberje të këtij fakulteti janë miratuar edhe programet e mëposhtme **Master të Nivelit të Parë në Mësuesi për CLAB** në lëndet: Histori – Gjeografi, Gjuhë – Letërsi Shqipe, Gjuhë – Letërsi Angleze, Matematikë – Fizikë, Matematikë – Informatikë dhe Biologji – Kimi.

▪ **Fakulteti i Shkencave Natyrore me keto programe studimi te ciklit te pare:**

- Matematike-Fizike,
- Matematike Informatike,
- Biologji-Kimi
- Infermieri e Larte.

Ne jeten e tij 38 vjeçare Universiteti i Gjirokastrës ka diplomuar me mijra studente ne te dy format e studimit, te cilet sherbejne ne fusha te ndryshme te dijes dhe shkences, duke dhene keshtu nje kontribut te vyer ne zhvillimin arsimor, ekonomik dhe shoqëror të vendit. Ne veprimtarine mesimore e shkencore te Universitetit te Gjirokastrës japin kontributin e tyre rreth 126 pedagogë te brendshem, 141 pedagogë te ftuar dhe 10 punonjes ndihmes mësimor - skencor. Nga personeli akademik 34 mbajne tituj e grada shkencore (9 “Prof.”, 10 “Prof.asoc.”,15 “Dr.”). Pjesa dërmuese e tyre kane kryer studime, kualifikime e specializime jashte shtetit, fale edhe lidhjeve te shumta qe UGJ ka krijuar me universitetet e vendeve te tjera.

Universiteti eshte i pajisur me rrjetin e internetit, laboratore, kabinete dhe nje biblioteke shkencore. Gjithashtu ai sherben edhe si nje qender e rendesishme kerkimore, shkencore e botuese. Pedagoget e tij kane qene e jane pjesemarres aktive ne konferenca, sesione shkencore e ne botime te ndryshme brenda e jashte vendit. Ai nxjerr edhe buletin e tij shkencor “Kerkime Universitare” me 2 periodiket e tij; ate te Matematikes dhe Shkencave Natyrore dhe ate te Shkencave Shoqërore e Ekonomike. Gjate vitit 2008-2009 u arrit qe Universiteti yne te jete anetar i rrjetit te Universiteteve Shqipfolese dhe i Unionit te Universiteteve Juglindore.

Universiteti yne ka pasur dhe vazhdon te kete lidhje dhe bashkepunim me te gjitha universitetet e tjera te vendit si dhe ka neneshkuar protokolle te bashkepunimit me Universitetin e Janines (Greqi), te Lecces (Itali), te Athines (Greqi), Kolegjin “Santa Mary” te Universitetit “Ave Maria” Michigan Detroid (SH B A) si dhe me Universitetin e Qipros.

Universiteti i Gjirokastrës ka kontakte të mira bashkepunimi me Universitetet e Patres e Selanikut (Greqi), te Potences (Itali), etj.. Ai u përfshi ne shume programe bashkepunimi ne kuadrin e projekteve Europiane “JEP”, ”TEMPUS”, ”PHARE”, “INTERREG I,II,III”, etj..

^ Gjithashtu bursat individuale qe kane perftuar pedagogët tanë ne kuader te programit “TEMPUS” kane ndikuar ndjeshem ne rritjen e kualifikimit dhe te pervojes se tyre pedagogjike-shkencore si dhe ne krijimin e kontakteve me mjaft pedagogë te universiteteve te vendeve te tjera.

Mbi bazen e pervojës dhe arritjeve të deritashme universiteti ka kryer disa studime që kanë lidhje me zhvillimin perspektiv të tij, qoftë në drejtim të ristrukturimit aq edhe në atë të zgjerimit me programe të reja studimi dhe veprimtari të tjera.

MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

A- MISIONI

Misioni i Universitetit përqendrohet në qëllimin kryesor që lidhet me nevojën për ndryshim e transformim dhe për krijimin e kapaciteteve reale të vlefshme për shoqërinë. Konkretisht ai është i fokusuar në:

- Përgatitjen e mesuesve për të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar.
- Përgatitjen e infermiereve të lartë.
- Përgatitjen e specialistëve të lartë të ekonomisë.
- Të shërbejë si një qendër e rëndësishme kërkimore – shkencore dhe botuese.

B- VIZIONI

Universiteti synon të pershtatet e t'i paraprijë zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Ai synon të kthehet në një qendër të edukimit të vazhdueshëm për Rajonin e Jugut. Universiteti i Gjirokastrës do të vazhdojë të jetë qendër e fuqishme për arsimimin dhe kërkimin shkencor të orientuar nga tregu i punës, nga reformat social-ekonomike dhe nga standartet e reja të integritimit evropian.

C- PRIORITETET STRATEGJIKE

1. **Niveli i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor në Universitetin e Gjirokastrës t'i paraprijnë dinamikës së ndryshimeve të shoqërisë shqiptare dhe prirjeve evropiane për t'iu përgjigjur plotësisht nevojave të së ardhmes së shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë, dhe asaj të Rajonit të Gjirokastrës në veçanti.**

- duke zhvilluar vazhdimisht burimet njerëzore dhe kulturen e cilesive;

- duke zgjeruar shumëllojshmërinë e misioneve pasi të bëhen ndryshime edhe në bazën ligjore të arsimit të lartë;
- duke orientuar veprimtarinë e universitetit për zhvillimin e rajonit të Gjirokastrës;
- duke konsoliduar dhe rritur kapacitetet ekzistuese që ka Universiteti;
- duke i edukuar studentët për një jetë qytetare aktive.

2. Çelja e programeve të reja të arsimit të lartë jouniversitar të ciklit të parë të orientuar në drejtimin profesional, si një rrugë kryesore për përmbushjen e rolit të Universitetit të Gjirokastrës në mbështetje të ekonomive lokale.

- studimi i nevojave që ka tregu i punës për specialistë të kualifikuar të fushave të ndryshme, si specialistë, teknikë, ekonomistë, mësues etj.;
- duke i hapur në kohë këto programe për zgjidhje të menjëhershme;
- duke i shpënë këto programe atje ku janë nevojat dhe kushtet më të përshtatshme.

3. Çelja e programeve të reja të studimit të nivelit universitar të ciklit të dytë dhe të tretë si edhe e programeve Master të Nivelit të Parë për Arsimin e Mesëm dhe Master të Nivelit të Dytë mbi bazën e programeve ekzistuese të ciklit të parë.

4. Krijimi i mundësive për realizimin në të ardhmen të formës së studimit në distancë.

5. Rritja e mëtejshme e autonomisë së Universitetit për të funksionuar efektivisht si institucion i shekullit XXI, duke u shndërruar në institucion publik.

- hapja ndaj komunitetit dhe grupeve të interesit, duke tërhequr mendimin e tyre lidhur me zgjerimin e Universitetit dhe buxhetin;
- përshtatja e metodave dhe niveleve të financimit në mënyrë që të inkurajohet tere sistemi për arritjen e objektivave të përgjithshme;
- konkurrimi përmes projekteve të ndryshme në shkallë rajonale dhe më gjerë;
- gjetja e mekanizmave për menaxhimin më të mirë të njësisë kryesore të universitetit dhe për sigurimin e llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme sa më transparente.

RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE EKZISTUESE TE STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TE REJA

A. Ristrukturimi i programeve ekzistuese të studimit

- Ristrukturimi i programeve të studimit u bë sipas kërkesave të Deklaratës së Bolonjës, mbi bazën e Udhëzimeve nr. 4, 14, 15 dhe 20 të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës.
- Kjo ishte një nismë e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës që kërkoi angazhimin e gjithë stafit akademik.
- Ristrukturimi kaloi përmes një procesi të vështirë për shkak të koncepteve të reja që futeshin në organizimin e tërë veprimtarisë mësimore, por edhe për shkak të moskuptimeve apo kundërshtimeve.
- Ky është një proces që do të vazhdojë edhe me tej, sepse ristrukturimi i programeve të studimit do të bëhet edhe për vitet e tjera të studimit.
- Për vitin akademik 2008-2009 i rristruaruan 14 programe studimi të ciklit të parë dhe u përmirësuan 100 për qind e kurrikulave të kurseve të para.

B. Hapja e programeve të reja të studimit dhe rritja e numrit të studenteve

Zgjerimi i Universitetit “E.Çabej” me programe të reja studimi është një objektiv i rëndësishëm.

1. Nje arritje e rëndësishme e UGJ-se për vitin akademik 2008-2009 ishte miratimi i 6 programeve të reja studimi në mesuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë për lëndet:

- Matematike-Fizike
- Matematike-Informatike
- Biologji-Kimi
- Histori-Gjeografi
- Gjuhë-Letërsi Shqipe
- Gjuhë-Letërsi Angleze

2. Do te punohet per çeljen e programeve te reja te studimit si me poshte:

a. Programe studimi te ciklit te pare:

- Specialiste ne fushen e shkencave gjeo-mjedisore e teritoriale
(Departamenti Biologji - Kimi, viti 2012)
- **Fizikë dhe teknologji informacioni (Departamenti Matematikë, Informatikë dhe Fizikë, viti 2012)**

b. Master te nivelit te pare ne:

- Kontabilitet Finance (*Departamenti Ekonomik, viti 2009*)
- Administrim Publik (*Departamenti Ekonomik, viti 2009*)
- Turizem (*Departamenti Ekonomik, viti 2009*)
- Gjuhe Letersi Italiane (*Departamenti i Gjuhëve të Huaja, viti 2009*)
- Mësues i Arsimit Fillor i Specializuar (*Departamenti edukimit dhe i Metodologjisë së Mësimdhënies, viti 2012*)

c. Master te nivelit te pare ne mesuesi per arsimin e mesem ne lendet:

- Matematike (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2009*)
- Fizike (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2009*)
- Informatike (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2009*)
- Biologji (*Departamenti Biologji – Kimi, viti 2009*)
- Histori (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2009*)
- Gjeografi (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2009*)
- Gjuhe Letersi Shqipe (*Departamenti Gjuhë Letërsi, viti 2009*)
- Gjuhe Letersi Italiane (*Departamenti i Gjuhëve të Huaja, viti 2010*)
- Gjuhë Angleze (*Departamenti i Gjuhëve të Huaja, viti 2010*)

d. Programe studimi te ciklit te dyte:

- Matematike (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2011*)
- Informatike (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2012*)
- Biologji (*Departamenti Biologji - Kimi, viti 2011*)
- Histori (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2011*)

- Arkeologji dhe administrim të pasurive arkeologjike
(*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2009*)
- Gjeografi (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2011*)
- Letërsi Shqipe (*Departamenti Gjuhë - Letërsi, viti 2012*)
- Gjuhësi (*Departamenti Gjuhë - Letërsi, viti 2012*)
- Gazetari (*Departamenti Gjuhë - Letërsi, viti 2013*)
- Kritikë Letrare (*Departamenti Gjuhë - Letërsi, viti 2013*)
- Gjuhe dhe Qytetërim Italian (*Departamenti i Gjuhëve të Huaja, viti 2012*)
- Gjuhe Angleze (*Departamenti i Gjuhëve të Huaja, viti 2012*)
- Përkthim – Interpretim (*Departamenti i Gjuhëve të Huaja, viti 2012*)
- Gjuhë, Letërsi Greke (*Departamenti Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, viti 2012*)
- Qytetërim Grek (*Departamenti Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, viti 2013*)
- Kontabilitet (*Departamenti Ekonomik, viti 2011*)
- Administrim Publik (*Departamenti Ekonomik, viti 2011*)
- Turizëm (*Departamenti Ekonomik, viti 2011*)

e. Master të nivelit të dytë në:

- Matematikë (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2011*)
- Biologji (*Departamenti Biologji - Kimi, viti 2011*)
- Histori (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2012*)
- Gjeografi (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2013*)
- Letërsi Shqipe (*Departamenti Gjuhë - Letërsi, viti 2013*)

f. Doktoraturë në:

- Matematikë (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2012*)
- Biologji (*Departamenti Biologji - Kimi, viti 2012*)
- Histori (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2012*)
- Gjeografi (*Departamenti Histori - Gjeografi, viti 2012*)
- Letërsi Shqipe (*Departamenti Gjuhë - Letërsi, viti 2012*)

g. Do të çelen keto programe studimi të Arsimit të Lartë jo universitar:

- Menaxhim të Pasurive Arkeologjike (*Departamenti Histori-Gjeografi, viti 2011*)
- Menaxhim Biznesi (*Departamenti Ekonomik, viti 2011*)
- Menaxhim Mjedisi (*Departamenti Biologji - Kimi, viti 2011*)
- Informatikë – Ekonomike (*Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2011*)

h. Në kuadër të programeve të formimit të vazhduar do të hapen këto kurse:

- Kurs 6 mujor për kompjuterizimin e kontabilitetit sipas teknologjive të reja (*Departamenti Ekonomik në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, viti 2011*).
- Kurs 3 mujor me punonjësit e pushtetit vendor për problemet e administrimit publik (*Departamenti Ekonomik, viti 2010*).
- Kurs 3 mujor për trajnimin e agjencive turistike (*Departamenti Ekonomik, viti 2012*)
- Kurs 6 mujor për përgatitjen e specialisteve për drejtimin e shkollës si drejtor shkolle, inspektor arsimit etj. (*Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, viti 2011*)

Per kete do te realizohet hartimi dhe percjellja ne kohe Agjencise se Akreditimit i dokumentacionit te nevojshem per çeljen e programeve te reja te studimit ne funksion te kerkesave dhe nevojave qe ka tregu i punes per specialist te fushave te ndryshme, duke u bazuar ne udhezimet perkatese te MASH-it (ne vijim duke filluar nga viti 2009, departamentet përkatëse)

3. Rritja e numrit të studenteve në programet e studimit të UGJ-së është nje objektivi i rendesishem. Per kete kerkohet:

- a. Persosja e mekanizmave te Matures Shteterore, duke u bazuar ne modelet me te perparuara te vendeve te tjera, si mjet nepermjet te cilit sigurohet hyrja ne IAL ne bashkëpunim me Agjencine e Vleresimit te Arritjeve.
- b. Ngritje e grupit per karrieren, i cili do te ndihmojë kandidatet te orientohen per te ardhmen e tyre.
- c. Pergatitja e nje prospektusi per te ndihmuar kandidatet te bejne zgjedhjet e tyre per kurset e studimit ne Arsimin e Larte.

- d. Zhvillimi i modularizimit dhe transferimit te krediteve, per te siguruar zgjedhje reale dhe mundesi transferimi si brenda UGJ- së po ashtu edhe midis UGJ-së dhe universiteteve të tjera.
- e. Stimulimi financiar i studenteve qe ndjekin studimet ne te ashtuquajturat programe studimi te veshtira “ te papreferuara”, i studenteve qe vijnë nga shtresa sociale ne nevoje si dhe te studenteve te shkelqyer.
- f. Stimulimi me pike krediti i studenteve qe kane frekuentim sistematik në procesit mësimor.

4. Universiteti i Gjirokastrës ka nje raport pedagog/studente 1 me 30, nderkohe qe ky raport ne shkalle kombetare eshte 1 me 26, ndersa BE e ka ate 1 me 20. Universiteti i Gjirokastrës i ka te gjitha mundesite qe te realizojë **objektivin e Strategjise Kombëtare të Arsimit të Lartë** për rritjen vjetore te numrit te studenteve ne formen e studimit me kohe te plote ne shkalle kombetare (2% deri ne 3% çdo vit) deri ne vitin 2013, duke rritur numrin e studenteve ne programet ekzistuese te studimit apo nepermjet hapjes se programeve te reja te studimit.

PERMIRESIMI I INFRASTRUKTURES SE UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”

Në bazë të sipërfaqes aktuale të mjediseve mësimore dhe çlodhëse, në vitin akademik 2008-2009 për çdo student llogariten 3,1 m².

Përgatitja e projekteve për ndërtimin e mjediseve për mësim, mjediseve të punës për pedagogët dhe krijimin e kushteve normale për administratën e Universitetit, që do të çojë në arritjen e standardeve:

1. Godinë e re universitare me sipërfaqe ndërtimi 3360 m², vlera e investimit 92 milion lekë, viti 2012.
2. Shtesë godine me sipërfaqe 500 m², vlera e projektit 50 milion lekë.
3. Rikonstruksion i laboratoreve të Biologjisë, Kimisë, Fizikës, Informatikës dhe pajisja e plotë e tyre me bazë materiale dhe laboratorike.
4. Ngritja e laboratorëve të reja:
 - Laboratori Kërkimor – Shkencor pranë Departamentit Biologji – Kimi.

- Laboratori Kërkimor – Shkencor pranë grupit mësimor-shkencor të Fizikës.

Në këtë mënyrë do të arrihet që kapaciteti i ndërtesave, pajisjeve dhe bibliotekave si dhe cilësia e shërbimit të ofruar prej tyre të shkojë drejtë standardeve rajonale.

REKRUTIMI I STAFIT TE RI AKADEMIK

1. Në bazë të nevojave për vitin akademik 2008-2009 u rekrutuan 9 pedagogë të rinj, sipas kriterëve të propozuara nga departamentet dhe te miratuara nga Senati Akademik, duke synuar rekrutimin e pedagogëve të kualifikuar ose që janë në proces kualifikimi.
2. Per vitin akademik 2009-2010 do te rekrutohen **XXXX** pedagogë të rinj, sipas kriterëve të propozuara nga departamentet dhe te miratuara nga Senati Akademik, duke synuar rekrutimin e pedagogëve të kualifikuar ose që janë në proces kualifikimi. Madje do te synohet edhe ne terheqjen e kontigjentit cilesor te te shkolluareve jashte vendit nepermjet mekanizmave motivuese.
3. Per vitin akademik 2010-2011 per shkak te hapjes se disa programeve te reja studimi do te rekrutohen **XXXX** pedagogë të rinj, sipas po të njëjtave kriterë.
4. Në kuadër të strategjisë për thithjen e trurit, “*Brain Gain*”, universiteti do të parashikojë çdo vit kuota për vende të lira pune, për të punësuar personel akademik , i cili:
 - ka përfunduar me vlerësim mbi mesataren studimet e doktoratës dhe ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” në universitete të huaja, të akredituara nga agjenci të njohura në shkallë ndërkombëtare;
 - pas përfundimit të studimeve të doktoratës ka qenë i punësuar në profesion në një universitet perëndimor ose qendër kërkimore.
5. Per çdo vit akademik nje pjese e mire e ngarkeses mesimore do te perballohet nga pedagoge te ftuar, duke synuar aktivizimin e pedagogeve cilesor nga Universiteti i Tiranës, e specialisteve te afte nga komuniteti si dhe te specialisteve te huaj nepermjet marreveshjeve, projekteve, protokolleve dhe programeve te bashkepunimit me universitetet Italiane, Franceze, Greke, Kosovare, Maqedonase dhe Amerikane.

6. Shumica e personelit të ri akademik, të kërkuar nga zgjerimi i sistemit (personelit shtesë), do të përqendrohet në **rolin mesimdhënës**, kryesisht në ciklin e parë dhe në programet e ndërmjetme jouniversitare.

MESIMDHENIA DHE TE NXENIT

a-Objektivat:

Procesi mesimor kërkon që në kuadrin e përfshirjes në sistemin e Bolonjes dhe të përmirësimit të cilësisë së të mesuarit të punohet në drejtim të:

1. Modernizimit të metodave dhe teknologjive të mesimdhënies, duke synuar në metodat ndërkohore dhe të përdorura tek studentet që zhvillojnë tek këta të fundit ato shprehje e kompetenca që u duhen atyre për të ardhmen.
2. Përmirësimit dhe pasurimit të përmbajtjes së programeve mesimore dhe ligjeratave me të reja bashkohore të shkencës.
3. Pajisjes së të diplomuarve me shprehje të përgjithshme dhe të transferueshme, si ato të analizës, të të menduarit, të arsytimit, paraqitjes dhe komunikimit.
4. Përmirësimit të kurrikulave në mënyrë të vazhdueshme për t'i bërë ato sa më fleksibile në raport me detyrat që shtrihet koha para specialistëve të tjerë.
5. Përfshirjes së të gjitha programeve të studimit të ciklit të parë në sistemin e kreditimit sipas deklaratës së Bolonjes (duke filluar nga viti shkollor 2007-2008 për vitet e para)
6. Përmirësimit të bazës materiale e laboratorike me aparaturë bashkohore (në vazhdim, me një aksion fillestar në buxhetin e vitit 2009)
7. Përmirësimi të mjediseve funksionale laboratorike në të ardhmen (në vijim).
8. Rritjes së fuqisë mbështetëse të teorisë me nivelin praktik – laboratorik duke fuqizuar laboratorët ekzistues.
9. Ristrukturimit të departamenteve dhe programeve të studimit për të gjetur homologe në botë.
10. Rritjes së pjesëmarrjes së studentëve në punën kërkimore-shkencore të pedagogëve.
11. Përmirësimit të cilësisë së praktikave profesionale dhe atyre në terren.

b-Veprimet që do të ndërmerren:

1. Evidentimi i permbajtjes se vjeteruar te mesimdhenies nga çdo departament dhe mbi kete baze programimi dhe realizimi i trajnimit te nevojshem te personelit akademik (2009 – 2010).
2. Kualifikime jashte shtetit, sidomos shkëmbime afatshkurtra të personelit akademik me universitete të huaja me të cilat Universiteti i Gjirokastrës ka marrëdhënie bashkëpunimi, sidomos me universitetet perëndimore, si nje menyre efikase për të zhvilluar shprehite mësimdhënëse të pedagogëve tanë. Për vitin akademik 2008-2009 u kualifikuan në Universitete të huaja 2 pedagogë.
3. Organizimi i shkëmbimit dhe perhapjes të përvojës se fituar per metodat e mesimdhenies të pedagogëve që kryejnë kualifikimin pedagogjik e shkencor jashtë shtetit.
4. Organizimi i kurseve afatshkurtra nga Departamenti i Edukimit dhe Metodologjise se Mesimdhenies me pedagogët e rinj që rekrutohen për të dhënë mësim në Departamentin Ekonomik dhe Departamentin e Infermierisë. (10 deri 25 shtator të çdo viti akademik.)
5. Vlerësimi i reagimit të studentëve për metodat e mësimdhënies të pedagogëve me anë të anketimeve të herëpashershme, nëpërmjet këshillave studentore etj. dhe publikimi i këtyre vlerësimeve për të ndrequr të metat e vërejtura. (2 herë ne vit, Rektorati).
6. Ngritja dhe funksionimi i Njesise se Sigurimin te Brendshëm të Cilësisë, e cila do të zhvillojë dhe promovojë performancën e personelit akademik. Sipas Strategjisë Kombëtare për Arsimin e Lartë, performanca më e mirë do të shpërblehet edhe financiarisht. Çdo vit, në **Ditën Akadematike të Universitetit**, do të promovohen dhe performancat më të mira të mësimdhënies së personelit akademik. (Korrik te çdo viti).
7. Hapja dhe plotësimi i **“Portofoli i Standardeve të Mësimdhënies”** nga çdo pedagog në kuadrin e përgatitjeve për futjen e treguesve konkretë të kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit që ofron universiteti ynë. **“Portofoli i Standardeve të Mësimdhënies”** do të plotësohet në fillim të vitit akademik nga çdo pedagog dhe do të përmbajë: kurrikulat për disiplinat a modulet që ai zhvillon; **leksionet e printuara për çdo disiplinë a modul, nga një kopje të teksteve a materialeve të tjera që ai përdor, llojin e mjeteve audiovizive etj.** Mbi këtë bazë departamentet dhe organet e tjera drejtuese në fakultete do të kontrollojnë përditësismin e kurrikulave, do të bëjnë vlerësimin e personelit akademik, sikurse e përcakton Ligji i

Arsimit të Lartë dhe do të programojnë trajnimin e nevojshëm të personelit akademik.

8. Ngritja e nje qendre studimore me ndikim ne fushen e punesimit te laureateve te Universitetit “E.Çabej” si dhe ne evidentimin e problematikave dhe sugjerimeve lidhur me metodat, planet dhe kurrikulat mesimore (brenda vitit 2013).
9. Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare me temë: “PROJEKTI BASILEUS DHE NDËRTIMI I HAPËSIRËS EVROPIANE TË ARSIMIT TË LARTË PËRMES BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETEVE NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL DHE EVROPIAN”, ku do të ftohen të marrin pjesë ekspertë të arsimit nga Këshilli i Evropës, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, dhe specialistë nga Universitetet jashte vendit. (Maj 2010).
10. Unifikimi i planeve dhe programeve mesimore me sihomologet tane (fillojne vitet e para ne 2007).
11. Fitimi i gradave e titujve akademik nga anetaret e departamenteve (gjithesej mbi 80% e stafit).
12. Kompletimi cilesor i personelit akademik te nevojshem.(ne vijim)
13. Pasurimi i vazhdueshem i bibliotekes me literature shkencore e pedagogjike dhe kompjuterizimi i saj, duke e kthyer ate ne qender burimore e mediateke per studentet, pedagoget e qytetaret (kompjuterizimi brenda 2010).
14. Te behet nje studim i detajuar per shkallen e shfrytezimit te pajisjeve ekzistuese dhe per mungesat ne kete fushe (nga çdo departament, 2009).
15. Rritja e fondeve qe do te harxhohen per bazen materiale e laboratorike (nga buxheti grant, nga te ardhurat e krijuara si dhe nga pjesemarrjet ne projekte, ne vijim)
16. Zgjerimi i përdorimit te mjeteve didaktike dhe sidomos atyre audiovizive ne procesin e te mesimor.(ne vijim). Per kete do te realizohet:
 - Vendosja e videoprojektorëve në 10 salla leksionesh.
 - Pajisja e departamenteve me të paktën një kompjuter për çdo 2 pedagogë, një printer dhe një fotokopjues për çdo grup mësimr – shkencor.
 - Ristrukturimi i laboratorëve të aktual.
 - Përgatitja e projekteve për labororet e reja (2 laboratorë të Departamentitn Biologji – Kimi, një laborator të Fizikës dhe një laborator të Departamentit të Infermjerisë)

- Përgatitja e projektit për rrjetin telematik të Universitetit.
17. Venia ne dispozicion te studenteve e teksteve, perkthimeve e cikleve te reja te leksioneve.
 18. Permiresimi i dokumentacionit zyrtar shkollor neper sekretarite mesimore sipas modeleve perendimore.(brenda vitit shkollor 2008-2009)
 19. Permiresimi i dokumentacionit zyrtar qe lidhet me mbarvajtjen dhe reformat ne procesin mesimor...(brenda qershorit te vitit 2009).
 20. Krijimi i zyres se informacionit dhe informimit studentor lidhur me gjithë aktivitetin mesimor e shkencor ne universitet. (2012)

c-Kufizimet qe duhen perballuar:

1. Mungesa e pajisjeve te pershtatshme per nje mesimdhene moderne.
2. Mungesa e fondeve te duhura per blerjet ne bazen materiale, etj.
3. Mungesat e fondeve e lehtesive portuale(vizave) per levizjen e lire te personelit akademik per te kontaktuar, konsultuar e krijuar bashkepunimin e nevojshem,shkembyer eksperienca e pervoja me homologet perkates neper bote.
4. Mungesa e specialisteve te ngushte brenda fushave perkatese si dhe e literatures specifike ne keto nivele.
5. Mungesa e mjediseve te pranueshme te punes per stafin akademik e shkencor (mjedise, telefonizim, informatizim,etj.), gje per te cilen se fundi po jepen zgjidhje.
6. Plan-botimet shume te kufizuara e te vogla.
7. Kufizimet financiare per kryerjen me rentabilitetin e duhur te praktikes profesionale apo asaj ne terren.
8. Mungesa e shkollave ushtrimore me varesi edhe te universitetit.
9. Ekzistenca e nje baze ligjore e n/ligjore me tendence centralizimi kompetencash.

d-Perballimi i ketyre kufizimeve:

1. Te rritet pesha e fondeve ne favor te bazes materiale dhe jo te zerave te tjere.
2. Te rriten financimet per krijimin e mjediseve te reja te punes.
3. Rritja e raporteve te kembimit te literatures me homologet tane ne bote mbi bazen e lidhjeve,projekteve e aktiviteteve te perbashketa.
4. MASH te mundesoje pajisjen me viza afatgjata te personelit akademik te institucioneve te Arsimit te Larte.

5. Te rriten perpjekjet e personelit akademik per permiresimin dhe pasurimin e bazes materiale qe varet nga forcat tona.
6. Rritja e cilesise se punes nga ana e personelit akademik.
7. Realizimi i hartimit te akteve normative me decentralizim kompetencash sa me afer njesive baze mesimore e shkencore.
8. Aktet normative ligjore e n/ligjore qe vijne nga MASH duhet t'i jene neneshtuar me pare diskutimeve te gjera publike neper universitete dhe jo vetem ne forumet drejtuese te tyre ku mpleksen konflikte interesash.
9. Heqja nga qarkullimi i nje dokumentacioni te panevojshem, qe nuk e gjejme tek sihomologet tane (p.sh: regjistrat e kursit, brenda 2009).

e-Matja e arritjeve:

1. Me % e personelit akademik te perfshire ne veprimtari zhvillimi per te permiresuar stilin dhe metodat e mesimdhenies.
2. Me numrin e personelit akademik te trajnuar per te zhvilluar shprehite e mesimdhenies.
3. Me % e rritjes se cilesise se procesit te nxenit e kerkimit nen driten e ndryshimeve te reja.
4. Me % e mases se kurrikulave te mbuluara e ilustruara nga baza materiale e didaktike.
5. Me sasine e individeve qe fitojne grada dhe tituj akademik.
6. Me sasine e botimit te teksteve, artikujve, monografive, etj.. nga personeli akademik.
7. Me sasine dhe cilesine e mjediseve te punes mesimore e shkencore
8. Me nivelin cilesor te pergatitjes se studenteve ne fushat perkatese.
9. Me % e pjesemarrjes se studenteve ne kerkimin shkencor.
10. Me numrin e studenteve te pranuar dhe numrin e atyre qe diplomohen
11. Perputhja e te diplomuareve me nevojat e tregut te punes dhe me politikat e punesimit
12. Nepermjet realizimit te ekuivalentimit te diplomave me vendet e Evropes.
13. Nepermjet raportit te vleresimit te brendshem te cilesise si dhe vleresimeve dhe opinionit te studenteve per mesimdhenien.
14. Nepermjet kontroleve, vleresimeve dhe anketimeve te konkludohet mbi aftesite e perballimit te problematikave qe u dalin ne jete ne qendrat e tyre te punes specialisteve te pergatitur nga ne.

KERKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE

Universiteti yne synon te konvertohet ne nje qender rajonale te edukimit dhe kerkimit shkencor. Ne veprimtarine mesimore-shkencore te universitetit japin ndihmesen e tyre rreth 267 pedagoge te brendshem dhe te ftuar si dhe 10 punonjës ndihmes-mesimor.

Nga personeli akademik 34 kane tituj e grada shkencore dhe pjesa dërrmuese eshte perfshire ne kualifikimin per fitimin e “Masterave”, “Doktoraturave” dhe titujve akademikë. Pjesa me e madhe e pedagogeve kane kryer studime, kualifikime e specializime jashte shtetit, fale lidhjeve te shumta dhe bashkepunimit qe UGJ ka krijuar me Universitetet e vendeve te tjera si ate te Janines, Patres, Athines e Selanikut ne Greqi, ate te Lecces, Firences, Kalabrise e Potences ne Itali, ate te Prishtines ne Kosove, ate te Tetoves ne Maqedoni, ate te Toluz III, ne France, ate te “Ave Mary” ne Michigan Detroid SHBA etj.

Pedagoget kane qene dhe jane pjesemarres aktiv ne projekte te ndryshme, ne konferenca e sesione shkencore, ne botime te ndryshme brenda e jashte vendit, etj.

Universiteti boton sot 2 buletine shkencore “**Kërkime Universitare**”

a- Periodiku “**Matematika dhe shkencat natyrore**” dhe

b- Periodiku “**Shkencat shoqërore dhe ekonomike**”.

Duke e konsideruar kerkimin shkencor kerkim e zhvillim, ne planin strategjik te universitetit parashikohen drejtime kryesore te kerkimit si dhe fusha konkrete prioritare si me poshte:

- *Mësimdhënia e mësimnxënia*
- *Metoda te edukimit ne distance*
- *Studime dhe kërkime në: Algjebër, analizë matematike, statistikë, bazë të dhënash, biofizikë, biodiversitet, kimi, mjedis, biologji.*
- *Probleme te ndryshme sociale te diktuar nga shoqeria dhe rajoni*
- *Probleme te zhvillimit historik e linguistik (Probleme te dygjuhesise)*
- *Probleme te integrimit te kulturave te ndryshme ne rajon*
- *Teknologjite e informacionit etj.*
- *Problemet e zhvillimit ekonomik te rajonit.*

a-Objektivat:

1. Rritja e pjesemarrjes se stafit akademik ne punen kerkimore – shkencore.

2. Konkurimi i stafit akademik te UGJ-se ne projekte akademike te kerkimit shkencor
3. Hartimi, zhvillimi apo pjesemarrja ne projektet kerkimore-shkencore kombetare e nderkombetare.
4. Perfshirja e studenteve ne punen kerkimore.
5. Vendosja e kerkimit ne funksion te komunitetit, mjedisit e shoqerise ne teresi.
6. Krijimi i nje rrjeti laboratorik ne nivel kombetar per realizimin e nje game te gjere kerkimi.
7. Vazhdimi me ritme te shpejta i kualifikimit te pedagoqeve pa grade me synim qe brenda vitit 2013, 80% e stafit te mbaje grada shkencore e tituj akademik.
8. Kryerja e nje pjese apo te gjitha studimeve te doktoratures ne universitetet e huaja te njohura nepermjet programit te veçante te emertuar "*Fondi i ekselences*".
9. Ndjekja e problematikave te perballimit te detyrave ne pune nga stafet e pergatitura prane departamenteve tona.
10. Rritja e cilësisë dhe e numrit të botimeve te pergatitura nga anetarët e departamenteve tona (artikuj, monografi, tekste mesimore, etj.,) si dhe cilësisë se tyre.

b-Veprimet qe do te ndermerren:

1. Hartimi i planeve te punes kerkimore sa me reale e te realizueshem per gjithë stafin akademik (ne vijim).
2. Hartimi i projekteve me grupe specialistesh nder departamentar brenda universitetit dhe per departamente te njejta midis universiteteve te ndryshme brenda e jashte vendit (në vijim).
3. Hartimi i projekteve shkencore kombetare e nderkombetare (ne vijim).
4. Perfshirja e te gjithë studenteve ne teza diplomash (duke filluar nga viti akademik 2009 - 2010).
5. Blerje aparaturash per realizimin e kerkimit shkencor (rregullisht nga 2009).
6. Rritja e fondit ne favor te kerkimit (per 2009 e vijim).
7. Krijimi i rrjetit kerkimor midis universiteteve te vendit me qellim marrjen e pervojës nga pedagoget e universiteteve te vogla nga ato me me pervojë e me te medha (brenda 2010).
8. Hartimi i planeve te punes kerkimore midis specialisteve te te njejtë specialitet te universiteteve te ndryshme te vendit (per çdo vit).

9. Zhvillimi i nje sere studimesh dhe aktivitetesh shkencore ne rang kombetar e nderkombetar dhe publikimi i tyre ne botimet shkencore te Buletinit “*Kerkime Universitare*”. (gjate gjithë kohes duke realizuar botimin e 2 deri 3 numrave te tij ne vit).

c-Kufizimet qe duhen perballuar:

1. Mungesat ne aparaturen laboratorike te nevojshme per perballimin e punes kerkimore.
2. Fondet e ulta ne dispozicion te punes kerkimore.
3. Mungesa e nje rrjeti kerkimor nderuniversitar e ndare sipas specialiteteve.
4. Kufizimet e ndryshme objektive per te marre pjese ne çfaredo lloji kerkimi nga çdokush specialist i departamentit apo universitetit.
5. Mungesa e nje koordinimi te puneve midis universiteteve e instituteve apo laboreve kerkimore te drejtorive apo njesive te tjera shteterore qe disponojne labore te tilla cilesore.

d-Perballimi i ketyre kufizimeve:

1. Te filloje nje reforme e plote ne pajisjet laboratorike kerkimore me ze specifik ne fondin e MASH-it e te çdo njesie ne universitete (nga 2010).
2. Te shihen burimet per rritjen e fondeve te kerkimit (tashme eshte hedhur nje hap) sidomos nga te ardhurat nga te tretet e sherbimet e ndryshme (ne vijim).
3. Te organizohet (ngrihet) rrjeti kerkimor kombetar nderuniversitar (deri 2011).
4. Hartimi i projekteve te perbashketa ndëruniversitare (çdo vit).
5. Sigurimi i literatures nga lidhjet e krijuara me universitetet e huaja (ne vijim).

e-Matja e arritjeve:

1. Me rezultatet qe do te arrihen ne fushen e kerkimit shkencor.
2. Me problematikat e shfaqura nga komuniteti e qe do te gjejne zgjidhje nga puna ne universitin tone.
3. Me numrin e teksteve, monografive, kumtesave, artikujve te botuara sidomos ne revista me indeks nderkombetar apo monografive te realizuara.

4. Me numrin e projekteve pjesemarrjes, realizues apo drejtues nga personeli yne akademik.
5. Me numrin e masterave te nivelit te dyte apo doktoraturave te udhehequra. (Keto te fundit duhet te realizohen ne bashkepunim pasi universitetet e vogla e kane te kufizuar kete mundesi).
6. Me sasine e individeve qe fitojne grada dhe tituj akademik.
7. Vleresimi i performances ne kerkimin shkencor dhe transferimin e teknologjive dhe njohurive do te behen edhe nepermjet udhezimeve qe do te dergohen nga MASH-i.

LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBETARE

a-Objektivat:

1. Rritja e rolit te UGJ-se ne ndihme te zhvillimit ekonomik dhe social, duke ofruar krahas mesimit edhe veprimtari te ndryshme praktike si konsulence, kerkim shkencor te aplikuar dhe sherbime te tjera, duke perftuar ne kete menyre te ardhura shtese. Klientet potencialë per keto sherbime do te jene komunitetet dhe bizneset lokale, organet e qeverisjes vendore e qendrore si dhe organizata te ndryshme donatore.
2. Shnderrimi i UGJ-se ne qender e zhvillimit rajonal me lidhja te forta me komunitetin lokal dhe me vemendje te veçante ndaj nevojave te ketij komuniteti.
3. Terheqja e mendimit te specialisteve rajonal me me ze ne politikat dhe strategjite e zhvillimit te universitetit me qellim ristrukturimin e programave ekzistuese apo edhe çeljen e programeve te reja te studimit ne funksion te nevojave dhe tregut te punes se rajonit.
4. Rritja e bashkepunimit dhe lidhjeve me Prefekturen, Qarkun, Bashkitë, Komunat, drejtoritë dhe agjencitë e ndryshme rajonale, OJF-të e ndryshme etj. në funksion te reflektimit te punes se universitetit drejt se drejti ne interes te komunitetit.
5. Angazhimi i resurseve laboratorike e njerezore rajonale ne aktivitetin mesimor e shkencor te universitetit.
6. Te punohet qe nepermjet sherbimeve te ndryshme ndaj komunitetit dhe pjesemarrjes ne projekte kombetare te sigurohen fonde investuese ne bazen materiale-teknike e literature. (
7. Te sigurohen edhe bashkepunime per te zgjidhur nje sere problemesh rajonale qe kane te bejne me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, zgjidhje per problemet qe shqetesojne rajonin e me gjere.

8. Sigurimi i mjeteve laboratorike nga koperimet me firma e laboratore shkencore nepermjet marrjes dhe dhënies kur disponohen dubla.
9. Te kontribuojë ne kryerjen e analizave per çertifikimin e produkteve blektorale e bujqesore e te agrobiznesit vendor.
10. Kualifikimi i mesueseve ne sherbim (ne bashkepunim me Drejtorite Arsimore dhe Qendren e Trajnimit te Mesueseve ne Tirane) dhe te specialisteve te fushave te tjera duke i azhornuar ata me te rejat me te fundit ne keto shkenca. (Hartimi i programeve per keto kurse kualifikimi brenda vitit 2009)
11. Te sherbeje si qender e kualifikimit te ekonomisteve te rajonit.
12. Te kontribuojë ne zgjidhjen e problemeve ekonomike te rajonit ne bashkepunim me pushtetin vendor.
13. Ngritja dhe funksionimi i *“Qendrës së të mësuarit gjatë gjithë jetës”* (2012)

b- Veprimet qe do te ndermerren:

1. Organizimi i workshopeve me komunitetin (sipas tematikave e rastit).
2. Terheqja e mendimit te specialisteve me ne ze ne rajon ne fushat perkatese deri ne funksionimin e nje komiteti konsultativ rajonal te politikave te zhvillimit te universitetit (brenda vitit 2010).
3. Ngritja dhe funksionimi i konferencave te shtypit dhe tryezave te rumbullakta.
4. Nënkuqdesin dhe planifikimin e *“Qendrës së të mësuarit gjatë gjithë jetës”*, të organizohen në mënyrë të vazhdueshme kurse kualifikimi për fusha e specialitete të ndryshme, për t’i bërë specialistët e këtyre fushave sa më atraktivë ndaj nevojave të tregut.
5. Ngritja e nje komiteti rajonal te politikave te zhvillimit me intelektualet me ne ze te rajonit (2010).
6. Trajnime ne funksion te sektorit privat ne rajon dhe tregut te punes. (në vijim).
7. Sigurimi i marrëveshjeve per bashkepunim e shfrytezim te laboratoreve te njeri-tjetrit. (në vijim).
8. Hartimi dhe zbatimi i projekteve dhe studimeve te perbashketa.
9. Shkembim pervoje ne fushat e mesimdhenies e mesimnxenies.
10. Te shihet mundesia e dhenies se patentave e çertifikatave jo nga agjenci te caktuara, shpesh jo kompetente, por nga universitetet.
11. Te krijojme rrjete sherbimesh shkencore ne dobi te sipermarresve privat.

c-Kufizimet qe duhen perballuar:

1. Mungesa e nje bashkekordinimi qendror nga agjencite e institucionet qendrore te kerkimit.
2. Mungesa e planeve kombetare sipas specifikave konkrete te secilit universitet.
3. Dhenia e kompetencave te çertifikimit te nje sere produktesh te siperarrësve private kontributit te universiteteve.
4. Indiferenca e komunitetit rajonal ne drejtim te puneve te universitetit.
5. Mungesa e nje rrjeti permanent komunikimi universitet-komunitet.
6. Mungesa e nje komiteti rajonal te sugjerimit te politikave te zhvillimit per universitetin.

d- Perballimi i ketyre kufizimeve:

1. Hartimi i planeve kombetare sipas specifikave perkatese.
2. Funkcionimi i nje forumi koordinativ me perfaqesues nga çdo dikaster.
3. Njohja e te drejtes se çertifikimit apo patentave laboreve kerkimore e shkencore te universiteteve.
4. Sensibilizimi i komunitetit nepermjet flete-palosjeve, publikimeve, work-shopeve, seminareve, konferencave, sesioneve, etj.
5. Funkcionimi i komitetit konsultativ te politikave te zhvillimit universitar.
6. Dhenia kronologjike e konferencave te shtypit lidhur me ecurite dhe veshtiresite qe has puna ne universitet.

e-Matja e arritjeve:

1. Me shkallen e lidhjeve mes UGJ dhe bizneseve persa i perket veprimtarive te perbashketa dhe kontratave.
2. Nepermjet indikatorit treg mbi produktet e prodhimit te çertifikuara nga labororet e universitetit.
3. Me masen e pjesemarrjes ndihmuese apo mbeshtetese te universiteteve ne aktivitetin prodhues te siperarrësve private.
4. Sa dhe si jane zgjidhur problematikat ku eshte bere pale edhe komuniteti?
5. Sa eshte degjuar zeri i komitetit konsultativ te politikave te zhvillimit te universitetit dhe si ka ndikuar kjo ne rezultatet e puneve te ketij te fundit?

6. Ç'sherbime dhe ç'problematika që lidhen me komunitetin janë zgjidhur me kontributin e personelit të universitetit.
7. Sasia e fondeve të thithura nga jashtë buxhetit shtetëror nga shërbimet ndaj të treteve.

ROLI NDERKOMBETAR

a-Objektivat:

1. Krijimi i bashkëpunimit ndërkombëtar si rezultat i përfshirjes në sistemin e Bolonjes dhe unifikimit të planeve të kurrikulave të lëndëve, cilësive të mesimdhënjës dhe normës së diplomimit (sipas afatëve të mesipërme).
2. Mbeshtetja në homologjet tane për përmirësimin e dokumentacionit zyrtar shkollor me përparesi në procedim sipas modeleve të tyre (në afatin e përcaktuar).
3. Përfitimi nga homologjet e huaja gjatë aktiviteteve të përbashkëta shkencore dhe nëpërmjet shkëmbimit të literaturës (në vijim).

b-Veprimet që do të ndërmerren:

1. Aktivizimi i homologëve tane të huaja në procesin tonë mesimor e shkencor. (në vijim).
2. Zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore e shkencore. (në vijim).
3. Botime të përbashkëta artikujsh, monografish, etj. dhe shkëmbime të tyre. (në vijim).
4. Shkëmbime në literaturë bashkëkohore. (në vijim).
5. Bashkëpunim për ndryshimin e dokumentacionit zyrtar të evidentimit të përparitit e likuidimit të detyrimeve nga ana e studentëve. (2011)

c-Kufizimet që duhen përballuar:

1. Mosmundësia e lëvizjes së lirë të pedagogëve tane për mungesë vizash.
2. Buxheti i kufizuar për lëvizjet jashtë shtetit.
3. Mos ekzistenca e strukturave drejtuese dhe kurseve të studimit tek në raport me ato homologe në bote (pra s'kemi homologë).
4. Mungesa e një baze materiale-laboratorike për të punuar së bashku me homologët e huaja në universitetin tonë.

d-Perballimi i ketyre kufizimeve:

1. Sigurimi i marrëveshjeve nderdikasteriale e nderqeveritare per mundesimin e levizjes se lire jashte vendit te personelit akademik te universiteteve tona.
2. Krijimi i nje zeri te veçant ne buxhetin e universitetit per shpenzimet e kontaktit.
3. Ristrukturimi i programeve te studimit sipas modeleve evropiane.
4. Forcimi i bazes materiale – laboratorike.

e-Matja e arritjeve:

1. Me sasine dhe cilesine e aktivizimit ne procesin tone mesimor te specialisteve te jashtem (te huaj).
2. Me numrin e projekteve,studimeve apo botimeve te perbashketa.
3. Me numrin e pjesemarrjes ne aktivitete te perbashketa nderkombetare.
4. Me perputhshmërine strukturore e dokumentacionare te programeve tona te studimit me ato homologe ne bote.

FINANCAT DHE BURIMET FINANCIARE

a-Objektivat:

1. Rritja e fondit grant i ardhur nga MASH-i dhe perdorimi me efijence te larte i tij.
2. Sigurimi i burimeve te tjera të të ardhurave për te plotesuar buxhetin e UGJ-se nepermjet:
 - **Rritjes se kontributit te studenteve** me kohe te plote dhe te pjesshme per te perballuar koston e arsimit te larte duke parashikuar diferencime ne nivelet e tarifave te shkollimit mes programeve dhe cikleve te ndryshme si dhe mes formave te studimit me kohe te plote dhe te pjesshme.
 - **Projekteve te ndryshme** qe do te paraqesin dhe zhvillojne departamentet si dhe nga **sherbimet** qe do te ofrojne ata per te ndihmuar zhvillimin lokal, rajonal dhe me gjere.
3. Dispeçerimi i fondeve të bëhet deri në nivel departamenti. Kjo autonomi do te punohet qe te realizohet brenda vitit 2013.

4. Fondet e krijuara nga shërbimet në departamente të përdoren në mënyre te pavarur nga departamentet. Për këtë del e nevojshme që të krijohet kuadri i plotë ligjor dhe të vendosen një sërë shërbimesh të pagueshme, konform tarifave përkatëse të miratuara nga vetë Këshillat e departamenteve.
5. Të formulohen akte n/ligjore mbi % e shpërndarjes së të ardhurave të krijuara nga puna e specialistëve të vetë departamenteve në shërbimet ndaj komunitetit.

b-Veprimet që do të ndermerren:

1. Debate lidhur me plotësimin e legjislacionit për problemet financiare. (në vijim).
2. Rritja e efektivitetit dhe transparencës në përdorimin e fondeve. (në vijim).
3. Plan i detajuar dhe i shoqëruar me kostot që të demonstrojë se çfarë shërbimesh synon të zhvillojë çdo departament. (2009 – 2010)

c-Kufizimet që duhen përballuar:

1. Sasia e vogël e fondeve në dispozicion.
2. Burimet e pakta të fondeve të thithura nga aktiviteti ndaj të tjerëve apo edhe projekteve të shërbimeve të tjera.

d-Perballimi i këtyre kufizimeve:

1. Miradministrimi i fondeve në dispozicion.
2. Planifikime me racionale të drejtshpërndarjes së fondeve në dispozicion.
3. Të vendosen tarifa shërbimesh për zëra të rinj që sot për sot ende behen falas nga departamentet.

e-Matja e arritjeve:

1. Me sasinë e fondeve të krijuara nga vete njësi.
2. Me problematikat që janë zgjidhur nga miradministrimi i fondeve.
3. Me raportet e efektivitetit krahasuar midis n/njesive të ndryshme.

KERKESAT FINANCIARE TE STRATEGJISE

.....

QEVERISJA BASHKËKOHORE

Autonomia, përgjegjshmëria dhe menaxhimi

1. Për t'iu përgjigjur sfidave të ndryshimeve të shpejta në shoqëri dhe ekonomi, IAL-të bashkëkohore kanë nevojë për **një autonomi të arsyeshme nga Qeveria**. Ligji i AL (2007) shënon një hap të rëndësishëm drejt rritjes së autonomisë së IAL-ve, ndonëse nuk i shndërron ato tërësisht nga institucione shtetërore në publike. Plani i Veprimit vendos detyra për hartimin e orientimeve kryesore për IAL-të se çfarë duhet të bëjnë ato për të qenë në përputhshmëri me ligjin e AL (2007). Çdo IAL do të përgatisë planin e saj strategjik 5-vjeçar, mbështetur në synimet dhe orientimet e kësaj Strategjie.
2. **Synimi afatgjatë është që çdo IAL të bëhet plotësisht autonome dhe të funksionojë si institucion publik.** Autonomia për IAL-të do të mbështetet në katër kolona dhe konkretisht në:
 - **autonominë akademike** – që nënkupton liritë akademike të individëve dhe atë të institucionit, që ky i fundit të mund të hartojë kurrikula novatore, përmbajtje të reja të lëndëve dhe, në kuadrin e Sigurimit të Cilësisë dhe kushtëzimeve financiare, të vendosë për hapjen apo mbylljen e programeve të studimeve dhe të formimeve. Kjo gjë do të ndikojë në përcaktimin e numrit të studentëve sipas fakulteteve për çdo IAL;
 - **autonominë strukturore** – që nënkupton se IAL-të do të përcaktojnë strukturat e tyre të brendshme (fakultete, departamente, etj.) dhe do t'i përshtatin ato në përputhje me ndryshimet e rrethanave dhe të nevojave;
 - **autonominë administrative** – që nënkupton se IAL-të do të përcaktojnë mënyrat se si do të vetëmenaxhohen në përputhje me misionin e tyre – gjithsesi brenda kornizës së orientimeve kombëtare dhe në përputhje me praktikën e përparuar;
 - **autonominë financiare** – që nënkupton se IAL-të do të kenë fleksibilitet të përcaktojnë shpërndarjen e burimeve të brendshme mbi bazën e planeve dhe të buxhetit si edhe shpenzimin e tyre,

brenda tavanit buxhetor. Kjo gjë ndikon në metodat e shpërndarjes së fondeve shtetërore për IAL-të.

Secili nga këto aspekte të autonomisë është i rëndësishëm për IAL-të e të ardhmes. Dy çështje kushtëzojnë një autonomi më të gjerë; zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të menaxhimit dhe forcimi i përgjegjshmërisë dhe i transparencës. Ato do të garantojnë që autonomia të mos rezultojë as anarki dhe as qeverisje diktatoriale.

3. Kushti i parë për IAL-të shtetërore që të fitojnë autonomi më të madhe, është që ato të kenë **menaxhim të brendshëm dhe vendimmarrje rigoroze e transparente, me llogaridhënie më të mirë**. Kjo gjë kërkon që IAL-të të kenë struktura të duhura dhe të praktikojnë procese të qarta menaxhimi.
4. **Koncepti modern** i menaxhimit është relativisht i ri për IAL-të (jo vetëm në Shqipëri) dhe ka të bëjë me:
 - përcaktimin e prioriteteve dhe realizimi i procesit të planifikimit dhe të hartimit të buxhetit mbi baza realiste dhe objektive;
 - respektimi i limiteve buxhetore të cilat janë të lidhura me politikën e ligji mbi buxhetin;
 - metodat e përcaktimit të përdorimit të burimeve të brendshme financiare përmes prioriteteve konkurruese;
 - monitorimin financiar dhe kontrollin në bazë IAL-je dhe fakulteti apo departamenti në varësi të njësisë buxhetore;
 - vendimet për nivelet e delegimit financiar;
 - mbështetjen e fuqishme profesionale për menaxhimin, si dhe kryesisht për aspektet financiare si dhe forcimin e rolit të Kancelarit (në zbatim të kërkesave të ligjit për AL (2007));
 - zhvillimin e politikave për përmirësimin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë e tjera akademike;
 - zbatimin dhe zhvillimin e procesit të Sigurimit të Cilësisë nga vetë IAL-të;
 - zhvillimin e kriterëve të punësimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të karrierës së tyre përzgjedhjen dhe rritjen në karrierë të personelit mbi bazën e kriterëve objektive;
 - menaxhimin treguesve të performancës së personelit si edhe përcaktimin e ngarkesës së punës;
 - strukturën e menaxhimit dhe përshkrimin e vendeve të punës të personave të përfshirë në aktivitetet manaxhues .

5. Ligji i AL (2007) kërkon prej IAL-ve të zhvillojnë secilin nga këto procese. **Plani i Veprimit parashikon që IAL-të të konceptojnë dhe të propozojnë procese qeverisëse dhe struktura për vendimmarrje.** Për këtë qëllim atyre do t'u ofrohet asistencë teknike e jashtme.
6. **Për të marrë vendime menaxhuese, çdo IAL ka nevojë për një grup të brendshëm menaxhimi, të kryesuar nga Rektori, dhe që do të përfshijë edhe autoritete të larta drejtuese** (normalisht Zv/Rektorin dhe Dekanët) dhe Kancelarin; ligji i AL (2007) i referohet këtij organi si Rektorat. Ky është një grup *i brendshëm* menaxhimi, i cili nuk është i njëjtë me Këshillin e *jashtëm*, që do të nevojitet për llogaridhënien, kur IAL-të të bëhen publike. Rektorati duhet të ketë terma të qarta reference dhe duhet të operojë me një dokumentacion, i cili, nëse nuk ka arsye të ruajtjes së sekretit, duhet të jetë i disponueshëm për komunitetin e IAL-ve. Kur procesi i qeverisjes të arrijë pjekurinë e tij, atëherë përgjegjësitë e Rektoratit duhet të përqendrohen mbi çështje të menaxhimit dhe financës; ndërsa ato të Senatit, mbi çështje akademike.
7. **Për të përmbushur synimin afatgjatë, që çdo IAL të gëzojë autonomi të plotë si institucion publik, Plani i Veprimit përcakton edhe hapat e mëtejshëm, krahas parakushteve për një qeverisje më efikase lidhur me menaxhimin e brendshëm dhe transparencën e jashtme. Pas përmbushjes së parakushteve, komponentët kryesorë të tyre do të përfshihen në Statutin e IAL-ve dhe ai do të fitojë statusin e IAL-së publike.**
8. Kushti i dytë lidhet me **llogaridhënien e jashtme.** Ligji i AL (2007) parashikon ngritjen e “Këshillit Administrativ” (KA) për çdo IAL, me një pakicë anëtarësh të jashtëm. Ky është zhvillim pozitiv drejt një prirjeje të qartë ndërkombëtare, që IAL-të publike të kenë “Borde”, ku shumica e anëtarëve përfaqësojnë grupet e jashtme të interesit. Anëtarët e brendshëm të KA-së zgjidhen nga personeli akademik, jo akademik dhe nga studentët.
9. **Me kohën, KA-të grumbullojnë përvojë dhe IAL-të do të binden për vlerën e tyre.** Kësisoj, ato mund të shndërrohen hap pas hapi në “Borde të Jashtme” (BJ), të përbërë nga një shumicë anëtarësh, që nuk janë të punësuar në strukturat e IAL-ve. Si të tillë, ato (BJ) do të kenë përgjegjësinë përfundimtare për miratimin e planeve dhe buxhetit të IAL-ve, për kontrollin e përgjithshëm financiar dhe për emërimin e autoriteteve të IAL-ve. **Bordet e Jashtme** nuk do të merren me çështjet e përditshme të menaxhimit të IAL-së (ajo do të jetë detyra e Rektoratit) dhe as me detyrat e Senatit për çështje akademike. **Transformimi i Këshillave të Administrimit në Borde të Jashtme** do

të pasqyrohet edhe në ndryshimin e statusit të institucioneve nga shtetërore në publike; ky ndryshim mund të mos ndodhë njëkohësisht në të gjitha IAL-të.

10. **Anëtarët e jashtëm të BJ-së do të përzgjidhen nga personalitete jo vetëm të fushës ekonomike dhe nga bizneset lokale, por edhe nga shoqëria civile, nga të diplomuarit e IAL-ve, nga institucione të sektorit publik, përfshirë edhe shkollat e mesme për ato IAL, që kanë si detyrë edhe formimin e mësuesve.** Çdo anëtar i jashtëm do të përzgjidhet në bazë të kompetencës. Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Shqiptare (KRUSH) do t'i kërkohet të japë sugjerimet e veta për mënyrën e zgjedhjes dhe përbërjen e anëtarëve të jashtëm të BJ.
11. **Llogaridhënia e jashtme, kërkon që IAL-të të publikojnë një raport vjetor,** i cili do të përfshijë arritjet e institucionit, që lidhen me tregues të specifikuar të performancës dhe me rezultatet e përfuara nga procesi i jashtëm i Sigurimit të Cilësisë. Raporti do të përfshijë edhe bilancin vjetor të IAL-ve, të monitoruar dhe kontrolluar në mënyrë të pavarur. Plani i Veprimit do të bëjë propozime për mënyrën e monitorimit si edhe për treguesit financiarë dhe të performancës të IAL-ve. Ky monitorim, së bashku me kontrollin e jashtëm të pavarur do të përbëjë një garanci ndaj keqpërdorimit të fondeve.
12. **Së fundi, lidhur me llogaridhënien, do të zbatohen tre nivele të pavarur kontrolli institucional të IAL-ve nga:**
 - Kontrolli i Lartë i Shtetit
 - Kontrolli i Brendshëm i Këshillit të Ministrave,
 - Drejtoria e Kontrollit të MASH-itKjo gjë mund të jetë kohë-shpenzuese, pasi ka mbivendosje të kontrolleve. Plani i Veprimit do të përfshijë një vlerësim, për të parë se si mund të ulet barra e kontrollit.
13. **Autonomia e plotë për IAL-të publike** do të kërkojë shumë përgatitje. Mund të ketë rezistencë nga ata, që nuk e dinë se kjo autonomi duhet mbështetur në llogaridhënien e jashtme dhe menaxhimin e brendshëm më të mirë; mund të ketë të tjerë të shqetësuar se do të humbin bazën e pushtetit të tyre. Ndryshimet në kulturën e menaxhimit do të jenë të konsiderueshme dhe mund të marrin më shumë kohë në disa IAL krahasuar me disa të tjera. Mbështetur në përvoja të ngjashme, i gjithë procesi në shkallë vendi mund të zgjasë deri në 10 vjet.

M B I
S I T U A C I O N I N
N E U G J

ANET E FORTA TE UGJ

1. Pervoja ne punen mesimore e shkencore e grumbulluar ne keto 38 vjete.
2. Kualifikimi i kenaqshem shkencor e pedagogjik i stafit tone akademik.
3. Ekzistenca e nje baze materiale e laboratorike baze per pune mesimore e kerkimore.
4. Ekzistenca e nje biblioteke tashme me nje pervoje te konsiderueshme.
5. Arritjet e deritashme nga stafi akademik si ne fushen akademike dhe ne ate shkencore.(studime,botime,projekte,etj.,etj..)
6. Ekzistenca e nje sere lidhjesh dhe raportesh pune me homologet tane brenda dhe jashte vendit.

Keto gjykime mbeshteten:

- a. Në punën kualifikuese që vazhdon me ritme të larta.
- b. Në përmirësimet e vazhdueshme të mbështetjes financiare.
- c. Në prezencën tashme të fondeve të veçanta në funksion të kerkimit.
- d. Në atë ç'ka kemi arritur deri me tashme.

ANET E DOBETA TE UGJ

1. Mungesa e kontigjentit cilesor ne pranimet e reja te trupes studentore.
2. Mospreferenca e te diplomuareve jashte vendit per te punuar ne universitetet rajonale.
3. Mungesa e mjediseve cilesore te punes akademike e asaj shkencore nga ana e stafit akademik.
4. Mungesa e nje biblioteke te pasur ne gjuhen shqipe dhe ate te huaj.

5. Mungesa e nje baze materiale – laboratorike ne nivelet e kerkuara nga koha.
6. Tradita shume e re krahasuar me homologet ne bote.
7. Mungesa e mjeteve te duhura financiare per mbeshtetjen e punes kerkimore –shkencore ne nivele bashkekohore.
8. Buxheti nuk administrohet duke u dispeçeruar deri ne njesite baze (Departamentet) ku paraqiten nevojat konkrete.

Keto gjykime mbeshteten:

- a. Ne krahasimin e gjendjes tone me sihomologet tane ne bote.
- b. Ne mungesat dhe problematikat qe na krijohen ne punen tone te perditshme.
- c. Ne pervojen tone disavjeçare te djeshme dhe te sotme.
- d. Ne rezultatet e arritura ne punen tone sot dhe ne te kaluaren.

**KUSHTET PER OPORTUNITETE TE UGJ TANI DHE NE TE
ARDHMEN
(LOKALE, RAJONALE, KOMBETARE E NDERKOMBETARE)**

1. Ekzistenca e vet universitetit tone ne nje nga trevat me arsimdashese te Republikes.
2. Karakteristikat e zones dhe rajonit ku ushtrohet aktiviteti universitar.
3. Ekzistenca e resurseve njerezore e materiale te afte per nje pune te kualifikuar.
4. Stafet e kualifikuara qe mund dhe jane te gatshme per oportunitetet e nevojshme ne sherbim te komunitetit dhe sipermarrjes private.
5. Nevojat shumeplanesh te ekonomise rajonale per fjalen e kualifikuar.
6. Interesat shumeplanesh te zones dhe universitetit tone.

**KERCENIMET E JASHTME ME TE CILAT PERBALLET UGJ DHE
BARRIERAT QE DUHEN KAPERCYER**

1. Mungesa e specialiteteve per zona te ngushta te kerkimit.
2. Mosperputhjet strukturore dhe teknike qe nuk te japin mundesine e gjetjes se homologeve ne Evrope e me gjere.

3. Prapambetja e trashëguar nga e kaluara.
4. Problematikat që kalon në përgjithësi aktualisht shoqëria jonë.
5. Konkurenca e pabarabartë me homologët e tij.
6. Hapja e Universiteteve dhe programeve të reja të studimit mbi bazën e gjykimëve jo profesionale dhe jashtë kriterëve e parametrave të kërkuara duke ndikuar drejt se drejti edhe në uljen e cilësisë së pranimeve në institucionet e Arsimit të Lartë.
7. Moskuptimet e drejta e mos zbatimet reale të autonomisë së organizimit, financimit e drejtimit në universitete, etj., etj..